



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 62 dt. 15.09.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 15.09.2014, pasi shqyrtoi projektet e rikonstruksionit të disa rrugëve dhe rrugicave në Gjirokastrë, të cilat janë hartuar nga bashkia e qytetit si dhe relacionin “ Mbi vizitën e kryer në Gjirokastrë lidhur me projektet dhe zbatimin e punimeve në rikonstruksionin e kalldrëmeve të qytetit” e përgatitur nga grupi i specialistëve të Ministrisë së Kulturës, IMK dhe DRKK Gjirokastrë,

VENDOSI:

1. Miratimin e projekteve të hartuara nga Bashkia e Gjirokastrës

- Rikonstruksioni i rrugës Alqi Kondi, (segmenti Shtëpia e pritjes- I Cumaku)
- Rikonstruksioni i rrugës “Astrit Karagjozi” (Dunavat-lagja Partizani).
- Rikonstruksioni i rrugës me Kalldrëm të Vezirit në L. Pazar i Vjetër.
- Sistemimi i rrugës “Kapo Baco” (Gurgai-Varosh).
- Sistemimi i rrugicave në L. Palorto pranë Hajdinit (rruga Karaifil Bello).
- Rikonstruksioni i rrugës “Dr. Laboviti” dhe “Foto Berberi” + Sokaku i të Marrëve (pranë shtëpisë së Ismail Kadaresë).

me kushtet e mëposhtme:

- Firma zbatuese të punësojë me kontratë një restaurator të licensuar nga KKR.
- Firma të nënkontraktojë një firmë restauruese të licensuar nga KKR, për restaurimin e kalldrëmit në rrugicën “Kapo Baco” prej 100 ml dhe rrugën “Astrit Karagjozi”.
- Caktohen dy specialistë Kreshnik Merxhani dhe Dorian Ceribashi nga DRKK e Gjirokastrës për mbikqyrjen e këtyre punimeve.

- Në “Sokakun e të Marrëve” të vazhdojë shtrimi me pllakë ngjyrë gri duke hequr figurat gjeometrike dhe pllakat me ngjyrë okër. Fillimet e bazamakëve të shkallëve duhet të bëhen me pllaka të gjera duke formuar 1cm dhëmb. DRKK Gjirokastër të hartojë projektin për rrugën me kalldrëm “Sokaku i të Marrëve” dhe Bashkia të financojë për këtë projekt vitin e ardhshëm.
 - Në rrugicën para shtëpisë të Z. Kadare të shqepet kalldrëmi i ndërtuar me gurë të bardhë dhe të zinj. Rrugica të shtrohet me kalldrëm me gur të zinj.
 - Pozicioni i kunetës të përcaktohet nga mbikqyrësit e DRKK Gjirokastër në varësi të funksionit më të mirë të kullimit të ujërave të shiut.
 - Të vendoset varianti i parë i ndriçimit i propozuar në projekt duke respektuar braçetën e përdorur në Gjirokastër me llamba LED.
 - Pozicionet dhe përmasat e ndriçuesve para vendosjes së tyre në objekt do të miratohen nga mbikqyrësit e DRKK Gjirokastër.
 - Sheshi para “Urani Rumbo” dhe përpara banesës Fico të shtohet me kalldrëm me gurë të bardhë dhe të zinj.
 - Muret mbajtëse dhe ndarëse të oborreve që ndodhen në sheshin para banesës Fico, të kenë konfiguracion karakteristik të mureve të qytetit Gjirokastër.
 - Kalldrëmi në rrugën “Dr.Laboviti” të shtrohet me kalldrëm të zi.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
 3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI

